



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 31, datë 10.06.2021

PËR
PËR DISA NDRYSHIME NË DISA VENDIME TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË
TERRITORIT DHE DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të neneve 28, 29 dhe 113, të Kodit të Procedurave Administrative; neneve 7, shkronja “ç”, 14/1, pika 2, 27, 28, pika 1, dhe 48 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; neneve 9 dhe 10/1, të Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të Bashkisë Tiranë, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimet e Vendimeve të poshtëshënuara të Këshillit Kombëtar të Territorit, me anë të të cilëve janë miratuar Leje Zhvillimi për objektet si vijon:
 - a. *Vendimi i KKT-së Nr.06, datë 14.04.2017 “Për miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: “Godinë polifunkionale DTA (Downtown Albania) me vendndodhje në Bulevardin “Bajram Curri”, Bashkia Tiranë”;*
 - b. *Vendimi i KKT-së Nr.10, datë 02.02.2018 “Për miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: “Godinë polifunkionale 4, 5, 11 dhe 21 kate, me 3 kate nëntokë “Book Building”, ndërmjet rrugës “28 nëntori” dhe rrugës “Abdi Toptani, Bashkia Tiranë”;*
 - c. *Vendimi i KKT-së Nr.05, datë 08.11.2019 “Për miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: “Zhvillimi kompleks për shtesë kati dhe ndryshime të ambienteve ekzistuese të hotelerisë, ndërtimin e ambienteve të reja për shërbime hotelerie, zyra dhe godinë rezidenciale”, me vendndodhje në Bashkinë Tiranë”.*
2. Hartat e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumentet e Rregulloreve të Veçanta, të miratuara me Vendimet përkatëse të Këshillit Kombëtar të Territorit, për objektet e përmendura në pikën 1, zëvendësohen me dokumentet bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Procedurat administrative/ligjore për miratimin e rishikimeve dhe/ose ndryshimeve në projekt gjatë ndërtimit dhe (sipas rastit) të shtyrjes së afatit, për objektet e përmendura në pikën 1, të këtij Vendimi, do të vijohen nga Bashkia Tiranë, sipas përcaktimeve dhe rregullave të parashikuara në dispozitat e Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për



miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, në përputhje me Marrëveshjet përkatëse “Për Delegimin e Kompetencave” të nënshkruara mes Kryetarit të Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Kryetarit të Bashkisë Tiranë, bashkëlidhur këtij Vendimi.

4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



A circular official stamp in blue ink is located to the right of the signature. The stamp contains the text 'REPUBLIKA E SHQIPËRISË' at the top, 'MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË' around the perimeter, and 'TIRANË' at the bottom. In the center of the stamp is the coat of arms of Albania.

ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIATOTA



A circular official stamp in blue ink is located below the signature. The stamp contains the text 'REPUBLIKA E SHQIPËRISË' at the top, 'AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT' around the perimeter, and 'MINISTRIA E KRYEMINISTRIT' at the bottom. In the center of the stamp is the coat of arms of Albania.